Pas funksionimit te plote te Sistemit te Menaxhimit te Cilesise me dokumentacionin perkates, Drejtoria e Sigurimit te Cilesise do te kete detyrat e meposhtme funksionale:

1. Promovimi i arritjeve te cilesise dhe permiresimit te performances ne te gjithe institucionin.
2. Kryerja e auditimeve te brendshme per pershtatshmerine e Sistemit.
3. Rishikim periodik i Politikes se Cilesise dhe Menaxhimit te Sistemit.
4. Sigurimi i pershtatshmerise me Kodin Rrugor Shqiptar, Mirembajtjen e rrugeve dhe normat evropiane per te gjitha projektimet e projekteve dhe parametrat e sigurise te rrugeve.
5. Sigurimi i zbatimit te politikave te Menaxhimit Ambjental ne projektet e rrugeve.
6. Sigurimi qe shpronosimet ndjekin rregullat e pergjegjesise sociale te ARrSh, dhe kryhen ne perputhje me manualin perkates.
7. Sigurimi qe kushtet e rrugeve dhe strukturave monitorohen sistematikisht.
8. Ofrimi i keshillimit dhe trajnimit, mjeteve dhe teknikave per te asistuar Drejtorite e tjera qe te arrijne cilesine.

Nen drejtimin e drejtorit, personeli i Drejtorise se Sigurimit te Cilesise do t'i kryeje detyrat e mesiperme ne fushat e meposhtme te ekspertizes:

- Siguria rrugore
- Ambjenti
- Ndikimi social
- Projektimi
- Strukturat



**Asistence Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve (DPRr) te Ristrukturuar -  
Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARrSh)**

- Materialet
- Gjeoteknika
- Hidrologjia

**DETYRAT FUNKSIONALE DREJTORIA E MIREMBAJTJES**

**C. Qellimi**

Te mirembaje rrjetin rrugor te administruar nga ARrSh, vete ose nepermjet kontraktoreve me buxhetin e alokuar dhe ne perputhje me Manualin e Mirembajtjes se Rrugeve, duke siguruar kushtet per nje trafik sa me te sigurte nepermjet zbatimit te iniciativave dhe politikave te sigurise rrugore, sipas Kodit Rrugor Shqiptar dhe Normave Evropiane.

**D. Detyrat Funktionale**

1. Pergatit dhe monitoron planet e mirembajtjes sipas procedurave te planifikimit, ne bashkepunim te ngushte me Drejtorine e Planifikimit.
2. Bashkepunon ngushte me Drejtorite Rajonale ne te gjitha aspektet e veprimtarive te mirembajtjes.
3. Pergatit Termat e References (ToRs) dhe dokumentat e tenderit per veprimtarite e mirembajtjes dhe kontratat e supervizionit te performances.
4. Drejton veprimtarite e brendshme te mirembajtjes brenda buxhetit te alokuar ose duke kerkuar fonde shtese kur kerkohet nga situatat emergjente.
5. Mbikqyr dhe vlereson veprimtarite e kontraktuara te mirembajtjes brenda buxhetit te alokuar.
6. Drejton sherbimet periodike sezonale (mirembajtjen dimerore), duke siguruar prioritetin e kushteve te nje trafiku normal e te sigurte.
7. Drejton ekipin pergjegjes per vleresimin dhe pranimin perfundimtar ne rrjetin kombetar, te rrugeve te reja ose te rikonstruara te ndertuara nga kontraktoret.

**Siguria rrugore**

1. Rishikon, kontrollon dhe monitoron aspektet e sigurise te rrugeve te reja/te rikonstruara.
2. Pergatit Termat e References (TORs) per punimet e sigurise rrugore.
3. Menaxhon RSA (Road Safety Audits) per projektet.
4. Menaxhon RSI (Road Safety Inspections) per ruget ekzistuese.
5. Supervizon zbatimin e projekteve te sinjalistikes dhe shenjave rrugore per projektet e reja ose ato ekzistuese.
6. Kryen analizen e pikave te zeza.
7. Menaxhon mbledhjen sistematike te te dhenave te askidenteve te qarkullimit rrugor (nga regjistrimet e MPPT) per ti inkorporuar ne Bazen e te dhenave te ARrSh.

Shenim: Pas nje periudhe tranzicioni, synohet qe veprimtarite e mirembajtjes te kontraktohen plotesisht nga sektori privat.

**DETYRAT FUNKSIONALE**

**DREJTORITE RAJONALE**

**E. Qellimi**

Te mirembaje rrjetin rrugor te administruar lokalisht, sipas planeve te punes lokale te pergatitura ose te plotesojne nevojat emergjente ne perputhje me manualin e Mirembajtjes Rrugore, duke siguruar kushtet e nje trafiku sa me te sigurte.

**F. Detyrat Funktionale**

**1. Mirembajtja rrugore**

- Pergatit plan te detajuar pune te bazuar ne planin e pergjithshem te ARrSh per mirembajtjen verore dhe dimerore.
- Pergatit proceduren e prokurimit dhe perfundimin e investimit pasues.
- Kryen sherbimet e veta te mirembajtjes per riparimet e vogla te planifikuara dhe per rastet emergjente.
- Menaxhon sherbimet e mirembajtjes te kontraktuara per riparime te medha te planifikuara.
- Miremban makinerite dhe pajisjet e sektorit, ne bashkepunim me Drejtorine e mirembajtjes, duke ekonomizuar konsumin/perdorimin.

**2. Mbledhja e te Dhenave Rrugore dhe raportimi**

- Kryen kontrole periodike te trafikut, sinjalistikes dhe kushteve te rruges dhe raporton ne baza mujore mbi situaten Drejtorine e Mirembajtjes.
- Aktualizon bazen e te dhenave rrugore me te dhenat e grumbulluara

**3. Administrimi i BNJ/personelit rajonal.**

**4. Mban Kontabilitetin/Maredheniet me Banken/Thesarin rajonal.**

**5. Merr pjese ne planifikimin dhe buxhetimin rajonal vjetor.**

**Shtojca 1-M**

**Drejtoria e Finances se**

**ARrSh**

**Asistence Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve (DPRr) te Ristrukturuar -  
Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARrSh)**

**ASISTENCE TEKNIKE PER DREJTORINE E PERGJITHSHME  
TE RRUGEVE (DPRr) TE RISTRUKTURUAR -  
AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR (ARrSh)**

**DREJTORIA E FINANCES E ARrSh Dokument Pune Nr. 6**

**Korrik 2010**

**EGIS BCEOM INTERNATIONAL**

**EGIS ROUTE**

**fe)egisbceom**  
International

 **egisroute**

**Asistence Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve (DPRr) te Ristrukturuar  
- Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

**1. Sektori i Finances ne DPRr- Gjendja Aktuale**

Aktualisht, Sektori i Finances ne Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve (DPRr) vepron si regjistruer i veprimeve ditore me thesarin, i ngarkuar per llogaritjet e kontabilitetit dhe pagesave te pagave dhe faturave si dhe regjistrimin e gjithe veprimeve me banken dhe arken. Keto veprime kryhen ne 4 kompjutera te pa lidhur me njeri -tjetrin.

Ne pergjithesi ka dyshim ndaj kompjuterave qe nuk jane nen kontrollin direkt te gjithsecilit. Puna kryhet duke perdorur programe kontabiliteti te krijuara vete dhe te kater kompjuterat nuk jane te lidhur me njeri -tjetrin. Ndersa nuk mund te pranohet menjehere, qe ndodhin gabime, prova eshte mbajtja paralel ne menyre manuale, e te dhenave qe jane ne te njejten kohe edhe ne kompjuter.

**2. Shqyrtim Krahasues midis Raportit te Bankes Boterore dhe Statuteve te DPRr.**

Raporti Final i Bankes Boterore (Dhjetor 2007) me titull "*Ndertimi i Kapaciteteve Institucionale dhe Shnderrimi i DPRr ne nje Nderrmarrje Publike*" jep nje pershkrim te shkurter te atyre qe duhet te jene funksionet kryesore te departamentit te Finances. Eshte e dobishme te krahasohen keto pershkrime me ato te paraqitura ne rregulloret e DPRr (pika 4.2) ashtu si dhe krahasimi i tyre me situaten qe mbizoteron aktualisht.

Kjo eshte paraqitur ne tabelen e meposhtme.

**Tabela 1: Shqyrtim krahasues i funksioneve te finances**

<b>Raporti Final i Bankes Boterore</b>	<b>Shenim</b>	<b>Rregulloret e DPRr</b>
Zbatimi dhe venia ne pune e Sistemit te Kontabilitetit Financiar dhe Monitorimit te Projekteve (SKFMP)	(a)	<i>Shih shenimet qe jepen ne kete tabele</i>
Monitorim i veprimtarive financiare ne perputhje me pro^edurat e ARrSh dhe ligjin Shqiptar.	(b)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- pergjegjes per menaxhimin e fondeve, si te buxhetit te shtetit edhe nga te ardhura te tjera.</li> <li>- hedhje te dhenash dhe kryerje e pagesave brenda afateve ne Ministrine e Finances. Koordinon me projektet e donatoreve te huaj, per pagesa te bera jashte buxhetit te shtetit.</li> <li>- koordinon dhe likujdon ne kohen e duhur te gjitha detyrimet e paleve te treta.</li> <li>- merr pjese ne blerjet e vogla sipas ligjit.</li> <li>- mban te gjithe dokumentacionin e bankes dhe regjistron te dhenat ne ditar.</li> <li>- mbyll bilancin brenda afateve te vendosura.</li> <li>- mban arken dhe regjistrimet e duhura.</li> <li>- mban ditarin e pagave.</li> <li>- Pergatit borderone e personelit dhe eshte pergjegjes per mbajten e saj sipas ligjit mbi punonjesit dhe pagat dhe mban llogarite e duhura. Mban analizat e llogarive te paguara.</li> <li>- Pergatit borderote e sigurimeve shoqerore dhe te tjera ne perputhje me rregullat e sigurimeve shoqerore dhe</li> </ul>

**Asistence Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve (DPRr) te Ristrukturuar  
- Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

		kryen cdo veprim tjeter ne lidhje me to. - Mban listat e personelit dhe fondit te pagave.
Cakton auditore te pavarur per te ndihmuar njesine e prokurimeve ashtu sic kerkohet dhe mbikqyr veprimet e tyre.	(c)	
Harton kerkesen e buxhetit per ARrSh me mbeshtetjen nga njesite perkatese.	(d)	Harton propozimin e buxhetit dhe programet ne fushen financiare, ndjek dhe raporton ecurine e tyre ?do dy muaj.
Zbaton procedura administrative dhe miremban arkivat ne perputhje me rregulloret e ARrSh.		Mban librin mbi veprimet me thesarin, ditarin me banken dhe per veprime te ndryshme ditore, mban Big Book-un dhe ben plotesime per ?do ze me thesarin. Pergatit te dhenat mbi perfundimin e buxhetit per vitin fiskal te mbyllur dhe llogarite vjetore (te aseteve).
Pergatit raporte sipas kerkesave dhe i raporton drejtuesve dhe perdoruesve te rruges.	(e)	Merr pjese ne plotesimin e dokumentacionit per pagesat me thesarin dhe mbylljen e bilancit.
Kryen vleresimet e stafit dhe monitoron perputhjen me objektivat e vendosura.	(f)	Merr pjese ne hartimin dhe rishikimin e programeve te zhvillimit ekonomik dhe shoqeror, duke vleresuar ne ve^anti aspektet financiare te ketyre programeve.
Mbeshtet zbatimin e programit te ndertimit te kapaciteteve te burimeve njerezore per drejtorine e Finances.		

Burimi: Ndertimi i kapaciteteve institucionale dhe shnderrimi i DPRr ne nje ndermarrje publike, Shtojca 1 - Veprimtarite kryesore te Drejtorive/Departmanteve te ARrSh (faqja 7)

Nese rregulloret e DPRr teorikisht korrespondojne me kerkesat e raportit te Bankes Boterore, veprimtarite ekzistuese te Sektorit te Finances ne DPRr duket qe jane larg nga zbatimi i ketyre kerkesave.

Analizat e ketij krahasimi nenvizojne disa dobesi, si me poshte:

- (a) Banka Boterore rekomandon instalimin e nje programi te kompjuterizuar te Sistemit te Kontabilitetit Financiar dhe Monitorimit te Projekteve. Ky SKFMP i njohur si "Kontrolli i Kostos "ose "Kontabiliteti Analitik", nuk ekziston dhe duhet te krijohet plotesisht.
- Gjate zbatimit te projektit, procedurat per kontrollin e projektit dhe mbajtjen e te dhenave behen mjete te nevojshme per drejtuesit dhe pjesemarresit e tjere ne procesin e punes. Keto mjete sherbejne per qellimin e dyfishte, te regjistrimit te veprimeve financiare qe kryhen, si dhe per tu dhene drejtuesve nje tregues lidhur me progresin dhe problemet qe shoqerojne projektin.
- (b) Me perjashtim te projekteve te financuara nga jashte, monitorimi i detajuar financiar i veprimtarive nuk ekziston, dhe DPRr nuk kryen ndonje kontroll kostoje mbi punet. Ne menyre logjike, buxheti per ?do projekt duhet te ndiqet me kujdes dhe ne menyre sa me te detajuar duke perfshire cdo informacion financiar (faturat e kontraktorit, cdo shtese kontrate, etj ). Ndryshimet ne kontrate duhet te raportohet mbi baza ditore.

**Asistence Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve (DPRr) te Ristrukturuar  
- Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

- (c) Ne asnje rast Drejtoria e Finances nuk do te marre pergjegjesine te caktoje nje auditor, per ?do lloj qellimi. Kjo pergjegjesi eshte vetem ne kompetencat e Drejtorit te Pergjithshem.
- (d) Departamenti teknik dhe rajonet, sipas projekteve te tyre, hartojne propozimet per buxhetin dhe nevojat vjetore per mirembajtjen, te rishikuara nga Drejtori i Pergjithshem dhe paraqiten ne Ministri. Me pas, Ministria e Financave merr vendimin perfundimtar.
- (e) Raportet kane te bejne vetem me kontabilitetin, bilancet, dhe llogarite e fitimit, dhe nuk mund te konsiderohen si nje sistem raportimi real per te mbeshtetur marrjen e vendimeve nga drejtuesit.
- (f) Rekrutimi i stafit, ashtu si dhe programi i ndertimit te kapaciteteve nuk eshte pjese e veprimtarise se departamentit te finances.

Duhet theksuar qe, **sistemi i informacionit** i cituar ne raportin e Bankes Boterore mungon ne rregulloret aktuale te DPRr, te cilat fokusohen kryesisht mbi procedurat e kontabilitetit. Ne kete faze keto nuk mund te perdoren si mjet drejtimi ashtu sikurse duhet te jene.

Drejtori i Pergjithshem merr vendimet financiare dhe nuk duket qe te kerkohen edhe pikepamjet e Drejtorit te Finances lidhur me kete. Nuk eshte marr ndonje vendim ne nivelin e Sektorit te Finances ne DPRr, per me teper eshte Drejtori i Pergjithshem ai qe merr ?do vendim qe perfshin nje veprim financiar. Personeli i Sektorit te Finances jane vetem llogaritare te thjeshte.

### **3. Objektivat e Drejtorise se Finances te ARrSh.**

Per te krijuar sistemin e duhur te menaxhimit financiar te pajtueshem me Standartet Nderkombetare Financiare te Raportimit (IFRS), Sektori aktual i Finances i DPRr ka nevojte per nje perteritje perpara kalimit si Drejtoria e Finances e ARrSh.

Qellimi i ndryshimit te struktures se njesise se kontabilitetit eshte per t'i dhene Drejtorise se Finances se ARrSh, detyra shtese perve? detyrave te kontabilitetit dhe atyre fiskale. Kjo Drejtori duhet te kete mjetet e nevojshme per te siguruar qe kryerja e te gjitha puneve eshte arritur ne te njejten kohe, sikurse e percaktojne buxhetet e specifikuara; dhe ve?anerisht te monitoroje prirjet e shpenzimeve financiare te projekteve dhe te mundesoje ndermarrjen e veprimeve per te ndaluar ndryshimet nga linja fillestare e buxhetit te tyre.

Kontabiliteti modern, duke perdorur Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit (IAS) dhe Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (IFRS), u jep drejtuesve mundesine per te ndjekur ne baza ditore progresin financiar te punimeve per te siguruar efi^ensen e kostove.

Ne menyre te ngjashme, do te jete gjithashtu e nevojshme ndertimi i nje sistemi buxhetimi te bazuar ne performancen dhe arritjen e objektivave te identifikuara ne secilin project, ne Drejtorine e re te Finances. Duhet te krijohet nje Sistemi i Kontrollit te Kostove (Monitorimit te projektit) me qellim qe kostot reale te mund te krahasohen me buxhetin fillestar ne baza mujore.

#### **3.1 Kontrolli i Kostove dhe Monitorimi i Projektit**

Per kontrollin e kosos ne nje projekt, oferta e kontraktorit dhe vleresimet shoqeruese te gjendjes se likujditetit (cash flow) mund te ofrojne informacion reference baze per monitorimin dhe kontrollin pasues te projektit.

Per programet e projekteve, progresi ne veprimtarite individuale dhe arritja e permbushjes se objektivave mund te krahasohet me programin e projektit per te monitoruar progresin e veprimtarive. Specifikimet e kontrates dhe te punes sigurojne kriteret per vleresimin dhe sigurimin e cilesise se kerkuar te punes.

**Asistence Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve (DPRr) te Ristrukturuar  
- Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

Vleresimi perfundimtar ose i detajuar i kostove jep bazen per vleresimin e performances financiare gjate projektit, duke ndjekur ngushtesisht buxhetin fillestar. Ne varesi te nivelit qe kostot jane brenda vleresimit te detajuar te tyre, atehere projekti mendohet te jete nen kontrollin financiar.

Tejkalimet ne kategorite e vecanta te kostove japin sinjalin per mundesine e problemeve dhe tregojne se fare problemesh jane shfaqur saktesisht. Shpenzimet e orientuara drejt planifikimit dhe kontrollit te ndertimit perqendrohen ne kategorite e perfshira ne vleresimin perfundimtar te kostove. Ky perqendrim eshte vefanerisht i pershtatshem per projekte me pak veprimtari dhe perseritje te konsiderueshme te tyre si nivelimi dhe asfaltimi i rrugeve.

Per qellimet e kontrollit dhe monitorimit, vleresimi origjinal i detajuar i kostove shnderrohet ne nje projekt buxhet, dhe ky projekt perdoret me pas si nje udhezues per menaxhimin. feshitet specifike ne vleresimin e detajuar te kostove behen elemente te kostos se punes. Shpenzimet e kryera gjate ecurise se projektit jane te regjistruara ne llogarite specifike te kostos se punes per t'u krahasuar me vleresimet fillestare te kostos ne secilen kategori.

Keshtu, llogarite e kostos se punes individuale perfaqesojne pergjithesisht njesine baze per kontrollin e kostove. Ne menyre alternative, llogarite e kostos se punes mund te ndahen ne elemente te punes te cilet jane te lidhur me veprimtarite e vefanta te programuara edhe me llogarite e vefanta te kostove.

Per qellimin e menaxhimit dhe kontrollit te projektit, nuk eshte e mjaftueshme te merret parasysh vetem regjistrimi i kaluar i kostove dhe i te ardhurave te projektit. Drejtuesit e sukseshem duhet te perqendrohen ne te ardhurat e pritshme, kostot e pritshme dhe problemet teknike.

Per kete qellim, skemat tradicionale te kontabiliteti financiar nuk jane te pershtatshme per te pasqyruar natyren dinamike te projektit. Llogarite fokusohen ne menyre tipike ne regjistrimin e kostove rutine dhe te shpenzimeve te ndodhura ne te kaluaren, te shoqeruara me aktivitetet perkatese.

Ne pergjithesi, shpenzimet e ndodhura ne te kaluaren perfaqesojne kosto te ndodhura ne te kaluaren (*sunk costs*) qe nuk mund te rikuperohen, dhe qe nuk mund te ndryshohen ne te ardhmen dhe mund te jene ose mund te mos jene relevante per te ardhmen. Meqenese llogarite financiare jane historike per nga natyra, disa menyra te parashikimit ose hartimit te drejtimit te projektit ne te ardhmen jane thelbesore per kontrollin e drejtimit.

### **3.2 Sistemi Financiar i Kontabilitetit dhe Llogarite e Kostos**

Informacioni mbi kontabilitetin perdoret per tre qellime te ndryshme, si me poshte:

- Raportimi i brendshem per drejtuesit e projektit per planifikimin, monitorimin dhe kontrollin ditor
- Raportim i brendshem per drejtuesit per planifikimin ndihmes strategjik.
- Raportim i jashtem per qeverine, dhe palet te tjera te jashtme

Raportimet jashte ARrSh jane te detyrueshme ne formate dhe procedura te vefanta sipas kerkesave te raportimit qeveritar ose sipas praktikave te kontabilitetit te pranuar ne pergjithesi. Pergatitja e raporteve te tilla te jashtme i referohet kontabilitetit financiar. Ne krahasim me kete, kontabiliteti i kostos ose ai drejtues ka per qellim te ndihmoje drejtuesit e brendshem ne pergjegjesite e tyre te planifikimit, monitorimit dhe kontrollit.


Kostot e projektit jane gjithmone te perfshira ne sistemin e llogarive financiare te shoqeruara me organizimin. Te gjitha shpenzimet jane te regjistruara ne librin kryesor. Libri kryesor i llogarive jep bazen per raportet e menaxhimit si dhe llogarite financiare per gjithe organizaten.

**Asistence Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve (DPRr) te Ristrukturuar  
- Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

Per te zbatuar nje sistem modern te kontabilitetit financiar dhe nje sistem monitorimi te besueshem te projektit, do te jete e nevojshme te rekrutohen njerez me aftesite dhe kompetencat e duhura per te siguruar qe Drejtoria e Finances sherben si nje mjet pozitiv per drejtimin e ARrSh.

**4. Struktura e re e Propozuar**

Perqendrimi i menaxhimit financiar ne zyren qendrore te ARrSh dhe perfshirja e 3 rajoneve eshte propozuar ne strukturen e meposhtme:



Kjo strukture do te kerkoje program kontabiliteti te vefante dhe te gjithë kompjuterat qe kane nevojë, do te lidhen nepermjet internetit. Si rrjedhim, te gjitha veprimet financiare do te centralizohen ne kohe reale ne kompjuterin kryesor te zyres qendrore, me secilin financier ne zyren qendrore, si dhe me pergjegjesit ne secilin nga 3 rajonet, duke qene te afte te punojne me te njejtin program, ne te njejten kohe.

Kompjuteri kryesor mund te vendoset ne zyren e drejtorit te Finances. Te gjithë kompjuterat e financiereve te tjere do te lidhen me kompjuterin e drejtorit te Finances nepermjet rrjeti te gjere (WAN). £do kompjuter do te perdore programin e kontabilitetit ne kohe reale.

Drejtori i Finances, ne zyren qendrore te ARrSh do te perqendroje te gjitha te dhenat ne kompjuterin kryesor, dhe do te kete mundesine, qe nepermjet kompjuterit te tij, te krijojë raportet e kerkuara ne fdo kohe. Roli i tij do te perqendrohet se pari ne dhenien e pergjigjeve ndaj kerkesave per informacion financiar, kontabilitetin dhe monitorimin e projektit dhe dergimin e nje informacioni te tille mbi projekte te ndryshme tek drejtuesit e larte.

Per momentin, supozohet qe puna ne 3 rajonet do te kete te beje me punimet e mirembajtjes se rrugeve dhe jo me projekte zhvillimi.

**Aftesite e kerkuara**

Brenda struktures se re te propozuar, propozohet qe pozicioni i **Drejtorit Financiar** te kryeje detyrat e meposhtme:

- sigurimi dhe interpretimi i informacionit financiar;
- monitorimi dhe interpretimi i gjendjes se likujditetit (cash flow) dhe parashikimi i prirjeve per te ardhmen;
- monitorimi dhe progresi financiar i punimeve per secilin projekt;
- analizimi i ndryshimeve dhe keshillimi sipas tyre;



**Asistence Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve (DPRr) te Ristrukturuar  
- Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

- formulim i planeve strategjike dhe afat - gjate te biznesit;
- kerkimi dhe raportimi mbi faktoret qe ndikojne ne performancen e punes;
- zhvillimi i mekanizmave te menaxhimit financiar qe minimizojne riskun financiar;
- kryerja e rishikimeve dhe vleresimeve per mundesite per reduktim kostosh;
- menaxhimi i kontabilitetit financiar se kompanise, sistemeve te monitorimit dhe raportimit;
- lidhja me auditoret per te siguruar nese eshte kryer monitorimi vjetor;
- zhvillimi i marredhenieve te jashtme me kontaktet e duhura psh Ministria e Finances, MPWT, auditoret, juristet, punonjesit e bankave dhe organizatat statutore;
- hartimi i raporteve te duhura financiare ne afate te caktuara;
- menaxhim i buxheteve;
- gjetja e burimeve te reja financiare per te lehtesuar borxhet e kompanise;
- mbikqyrje e personelit;
- informimi mbi ndryshimet ne rregulloret dhe legjislacionin financiar

Idealisht, kandidati pe kete pozicion duhet te jete i diplomuar per biznes, me te pakten 3 ose 4 vjet eskeperience ne funksione te ngjashme ne sektorin publik dhe i familjarizuar me perdorimin e kompjuterit.

Pozicioni i **Pergjegjesit te Finances** pritet te permbushe keto detyra:

- te hartoje dhe analizoje informacionin financiar per te pergatitur gjendjet financiare duke perfshire llogarite mujore dhe vjetore;
- te siguroje qe regjistrimet financiare mirembahen ne perputhje me politikat dhe procedurat e pranuar;
- te siguroje plotesimin e te gjitha afateve te raportimit financiar;
- pergatitja e raporteve te menaxhimit financiar;
- te siguroje mbyllje mujore, 3 mujore dhe vjetore te sakta e ne kohe;
- percaktimi dhe monitorimi i zbatimit dhe mirembajtjes se procedurave te kontrollit te kontabilitetit;
- te zgjidhe mosperputhjet financiare dhe parregullsitet;
- menaxhim i vazhdueshem dhe mbeshtetje e veprimeve te buxhetimit dhe parashikimit;
- monitorim dhe mbeshtetje per ceshtjet e tatimeve;
- zhvillim dhe mirembajtje e bankes se te dhenave financiare;
- pergatitja e auditimit financiar dhe koordinimi i procesit te auditimit;
- te siguroje regjistrim te sakte dhe te duhur te te dhenave dhe analize te te ardhurave dhe shpenzimeve;
- analize dhe keshillim mbi veprimtarite e biznesit perfshire prirjet e te ardhurave dhe shpenzimeve, angazhimet financiare dhe te ardhurat ne te ardhmen;
- analize e informacionit financiar per te rekomanduar ose zhvilluar perdorimin efi?ent te burimeve dhe procedurave, ofrimin e rekomandimeve strategjike dhe te ndihmes ne zgjidhjen e problemeve te biznesit dhe atyre financiare

Financieret ne zyren qendrore dhe ato rajonale duhet te regjistrojne te gjitha levizjet financiare:

- ndjekja e veprimeve te arkes dhe regjistrimi i tyre
- ndjekja e veprimeve te magazines dhe regjistrimi i tyre
- mbajtja e ditarit te pagave
- pergatitja e listes se pagave te personelit dhe pergjegjesi per zbatimin e ligjit ne lidhje me pagat e punonjesve
- mbajtja e llogarive te pagesave
- pergatitja ne kohe e listes se pagesave ne lidhje me sigurimet shoqerore dhe sigurimet shtese, bazuar ne regjistrime dhe te kryeje ?do veprim tjeter ne lidhje me sigurimet shoqerore
- pergatitja e te dhenave te punonjesve dhe fondit te pagave
- marrja pjese ne kryejen e pagesave me thesarin dhe mbylljes se bilancit

Funksioni i financiereve rajonale duhet te kufizohet ne regjistrimin e levizjeve me

**Asistence Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve (DPRr) te Ristrukturuar  
- Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

thesarin ne rajone, te cilat jane kostot dhe pagesat per punimet e mirembajtjes se kryer sipas kontrates qe eshte ne fuqi pas tenderit.

**5. Programi i Kontabilitetit**

Struktura e re e ARrSh dhe numri i pritshem i personelit ka nevojte per nje sistem menaxhimi financiar te sofistikuar. Do te jete e mjaftueshme te fillohet me nje program te kuptueshem dhe modern kontabiliteti, ve?anerisht nese ky program eshte fleksibel per te pranuar shtimin e moduleve te ndryshme sipas nevojtes. Ne nje rast te tille, duhet te behet nje percaktim i sakte i kerkesave dhe t'i paraqitet ofruesit te programit, i cili me pas mund te ofroje nje program sipas ketyre kerkesave me ?mimin e tij fillestar.

Ne kete faze, eshte identifikuar nje program i pershtatshem ne tregun lokal, i cili perdoret ne sektorin publik shqiptar. Ky eshte *Alpha Platinum Buxhetor* nje program kontabiliteti per administraten publike, i cili eshte zhvilluar nga Instituti i Modelimit ne Biznesit (IMB). Nje pershkrim i karakteristikave funksionale te programit jepet ne Aneksin A te ketij dokumenti.

**6. Permbledhje e Detyrave Kryesore te Drejtorise se Finances se ARrSh**

(i) Regjistrimi

- regjistrimi dhe dokumentimi i veprimeve financiare;
- koordinimi i llogarive ne baza ditore, javore dhe mujore
- zhvillimi, zbatimi, rishikimi dhe dokumentimi i mbajtjes se regjistrimeve dhe sistemit te kontabilitetit.

(ii) Klasifikimi

- Gjetja e menyres se vleresimit dhe regjistrimit te kostove te projekteve dhe te caktimit te kostove per departamente te ndryshem dhe organizatave te tjera per keto raste.

(iii) Analiza

- shqyrtimi regjistrimeve te kontabilitetit, gjendjeve financiare dhe raporteve te tjera financiare per te vleresuar saktesine, te kuptuarit lehte dhe pershtatmerine me standartet e raportimit dhe procedurale;
- analiza e funksioneve te biznesit, prirjeve , kostove, dhe detyrimeve financiare;
- parashikimi i te ardhurave ( nga Ministria ) dhe shpenzimeve;
- vleresimi i gjendjes se likujditetit (cash flow) dhe risqeve financiare te shoqeruara me projektet e investimeve kapitale.

(iv) Auditimi

- kryerja e hetimeve financiare, ndermarrja e auditeve, hartimi i raporteve dhe zbulimi ne rast mashtrimi;
- sigurimi i garancise ne lidhje me origjinalitetin e informacionit qe permbajne raportet financiare dhe i besnikerise se tyre ndaj kerkesave te qeverise dhe rregulloreve;
- krijimi i nje Sistemi te Monitorimit te Projektit per ?do projekt.

(v) Raportimi

- raportimi tek drejtuesit per financat;
- llogaritja e detyrimit te taksave dhe pergatitja e deklarave tatimore;
- pergatitja e raporteve financiare per tu praqitur ne MPWT, bordin e drejtoreve, drejtuesve, dhe autoriteteve te detyrueshme, ne baza te rregullta ose sipas kerkeses.

(vi) Planifikimi

**Asistence Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve (DPRr) te Ristrukturuar  
- Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

- gjetja e metodave per kryerjen e punimeve ne menyre sa me eficente dhe ndihma ne hartimin e politikave buxhetore dhe te kontabilitetit;
- zhvillimi, mirembajtja dhe analiza e buxheteve per tu paraqitur ne MPWT;
- pergatitja e evidencave periodike qe krahasojne kostot e buxhetuara me ato aktuale;
- sigurimi i keshillimit financiar dhe mbi taksat, per menaxhimin, mbi strukturat, planet dhe veprimet;
- nderveprim me bankat dhe komisioneret per te krijuar marreveshjet e menaxhimit te fondeve, nese depozitat bankare lejohen sipas Ligjit.

(vii) Sistematizimi

- hartimi i kontroleve te brendshme te kontabilitetit per te minimizuar gabimet ne regjistrimet e biznesit;
- krijimi, zbatimi, ndryshimi dhe dokumentimi i sistemit te kontabilitetit;
- pergatitja e evidencave financiare dhe raporteve per drejtuesit e kompanise;
- regjistrimi i shumes se parave te shpenzuara dhe te marra nga MPWT;
- zhvillimi, parashikimi dhe kontrolli i buxheteve;
- sigurimi i perputhjes me legjislacionin e taksave;
- keshillim mbi aspektet financiare si psh buxhetin, taksat, dhe gjendjen e likuiditetit (cash flow);
- rishikimi i procedurave te kontabilitetit dhe analiza e performances financiare te ARrSh;
- asistence per drejtuesit me planifikim strategjik dhe burimet njerezore

**7. Opsionet funksionale per tu percaktuar - Centralizim ose Delegim**

Detyrat operative te rajoneve duhet te percaktohen shume saktesisht, nga nje kendveshtrim financiar. Ka pyetje dhe supozime te ndryshme qe kane nevojte te trajtohen:

- A do te kete rajoni autoritet per te vepruar me llogarine e vet bankare, duke marre me pare transfertat nga zyra qendrore sipas nje buxheti te propozuar? Apo roli i tij do te jete supervizioni dhe kontrolli i punimeve dhe aprovimi i faturave te nenkontraktorit qe duhet te paguhet nga zyra qendrore?
- Ne lidhje me pagesat e pagave, do te jene rajonet pergjegjese per trajtimin e pagave te punonjesve te tyre, apo te gjithe rregullimet e pagave do te behen ne zyren qendrore?
- Ne rastin e veprimtarise financiare te centralizuar, te gjitha pagesat do te perpunohen nga Drejtori i Finances ose nga Zevendesi i tij (Pergjegjesi i Finances)? Ky opsion do te zvogeloje ne menyre te konsiderueshme detyren e financiereve te rajoneve, vetem ne kontrollin, aprovimin, dhe kalimin e te gjitha dokumentave ne zyren qendrore.
- Kostot e puneve ndertuese te ndermarra nga zyrat rajonale supozohen te lidhura vetem me punimet e mirembajtjes. Ne kete rast, kontratat e mirembajtjes duhet te jene kontrata kuader me afat - per nje periudhe te caktuar - dhe duhet te tenderohen ne zyren qendrore per secilin rajon.
- Financieret e rajoneve, pas verifikimit dhe kontrollit nga Departamenti Teknik ne zyren qendrore, do ti kalojne faturat per punimet e kryera (sipas ?mimit per njesi te leshuar ne kohen e shpalljes se tenderit) ne zyren qendrore per t'u paguar.
- Ne menyre te ngjashme, zyra qendrore mund te ndermarre menaxhimin e gjithe personelit dhe pagave. Kjo nuk eshte nje detyre kryesore qe siguron se baza e te dhenave eshte krijuar ne menyre korrekte brenda programit te kontabilitetit. Perparesia kryesore e ketij opsioni eshte qe zyra qendrore do te kete kontroll te plote mbi shpenzimet.

Keto opsione dhe feshtje kane nevojte per tu diskutuar me Bordin Drejtues te ARrSh dhe Drejtorin e Pergjithshem, sapo ARrSh te filloje te funksionojte.

**Shtojca 1-N**

**Statuti i**

Asistenca Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve te ristrukturuar (DPRr) -  
Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)

**ARSh**

**Asistenca Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve te ristrukturuar (DPRr) -  
Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

**ASISTENCA TEKNIKE PER DREJTORINE E  
PERGJITHSHME TE RRUGEVE TE RISTRUKTUAR  
(DPRr) - AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR (ARSH)**

**STATUTI I AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR**

**DOKUMENT PUNE Nr. 14**

**Korrik 2011**

**EGIS INTERNATIONAL**

**@ egis International**



## **STATUTI AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR**

### **§ 1**

#### **Emri, Selia, Kohezgjatja**

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARSH), ne vijim referuar si "Autoriteti", eshte nje person juridik publik me seline e tij ne: \_\_\_\_\_ Tirane/Shqiperi dhe me zyra rajonale ne: \_\_\_\_\_. Kohezgjatja e veprimtarise se Autoritetit eshte e papercaktuar.

### **§ 2**

#### **Fusha e veprimtarise se ARSH**

- (1) Fusha e veprimtarise se Autoritetit eshte administrimi i rrjetit rrugor shteteror ne perputhje me percaktimet e Kodit Rrugor dhe ligjit "Per Autoritetin Rrugor Shqiptar".
- (2) Ne vijim te veprimtarise se percaktuar ne paragrafin 1, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Autoriteti mund te kryeje cdo funksion te drejperdrejte ose ne menyre te terthorte, si pasoje ose te lidhur me veprimtarine e percaktuar me siper. Ne permbushje te veprimtarise se tij Autoriteti mund te ndermarre transaksione tregtare, financiare, kredie ose huaperdorjeje, te cilat mund te konsiderohen te nevojshme ose te domosdoshme per kete veprimtari te Autoritetit.

### **§ 3**

#### **Kapitali i ARSH**

- (1) Ato pasuri te luajtshme (ose te paluajtshme), te cilat kane qene ne pronesi dhe administrim dhe jane perdorur kryesisht nga Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve, te cilat jane te domosdoshme per permbushjen e funksioneve te Autoritetit, perfshire te drejtat relevante, marredheniet juridike, detyrime, llogari te ardhurash dhe borxhi, me date \_\_\_\_\_, kalojne ne pronesi te Autoritetit me ane te transferimit te pergjithshem.
- (2) Vleresimi i pasurive te transferuara do te shenohen ne hapjen e bilancit te Autoriteti, i cili duhet te pergatitet brenda \_\_\_\_\_ pas dates se hyrjes ne fuqi te ketij statuti.  
Ne vleresimin e pasurive te transferuara gjate shenimit ne hapjen e bilancit te Autoritetit nuk eshte e domosdoshme te merret per baze kostoja e blerjes ose kostoja e prodhimit te tyre. Vleresimi i paisjeve dhe pasurise teknike duhet te behet ne perputhje me vleren e perdorimit te tyre duke marre per baze gjendjen aktuale te perdorimit.
- (3) Bilanci duhet te permbaje nje aneks, ku te perfshihet permbledhja e te gjitha aseteve dhe detyrimeve te domosdoshme ne funksion te Autoritetit te cilat do te transferohen nga Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve ne menyre transparente duke pasqyruar identitetin e kreditoreve dhe debitoreve gjate transferimit. Ne vijim ne aneksin e bilancit duhet te perfshihen te gjitha dhe 9do pasuri, marredhenie juridike dhe detyrimi te transferuara nga Ministria pergjegjese per Punet Publike, te cilat nuk mund te dallohen qarte ne bilanc. Transferimi i pasurive duhet te behet ne perputhje me rregullat e ligjit "Per Autoritetin Rrugor Shqiptar". Hapja e bilancit duhet te auditohet dhe miratohet nga eksperti i lincensuar, dhe raporti i ekspertit te licensuar, me ane te te cilit do te miratohet hapja e bilancit do te konsiderohet si raporti perfundimtar i bilancit.
- (4) Autoriteti duhet te mbaje dhe pergatise pasqyra dhe raporte financiare ne perputhje me rregullat e kontabilitetit ku te pasqyrohet me korrektesi e gjitha gjendja financiare e tij. Raportet financiare duhet te jene te detajuara sipas standardeve qe parashikojne ligjet ne fuqi qe rregullojne kete fushe.



**§ 4**  
**Financimi i ARSH**

(1) Autoriteti duhet te perballoje shpenzimet e tij:

1. Nga kontributet e vena ne dispozicion nga Keshilli i Ministrave/Ministria pergjegjese per transportin rrugor duke filluar nga data \_\_\_\_\_, ne formen e fondeve vjetore per mbulimin e shpenzimeve administrative ne permbushje te programit te punes. Ne vijim te ketyre fondeve baze, Keshilli i Ministrave, ne perputhje me ligjin "Per Buxhetin e Shtetit" mund te mbuloje edhe shpenzime te tjera shtese ne rast se keto te fundit jane te domosdoshme dhe Autoriteti ka vepruar ne perputhje me parimet e perdorimit te fondeve ne menyren me ekonomike, efektive dhe sipas praktikave me te mira te biznesit;
2. Nga kontributet e vena ne dispozicion nga Keshilli i Ministrave/Ministria pergjegjese per punet publike me qellim marrjen e masave operationale pe permbushjen e programeve te punes sipas fondeve te percaktuara per kete qellim ne Marreshjen per Nivelin e Sherbimit;
3. Nga pagesat te tjera te perfituara per kryerjen e sherbimeve per Ministrine pergjegjese per Punet Publike ose paleve te treta;
4. Nga kontribute te tjera publike ose private ne perputhje me ligjin;
5. Nga te ardhura te tjera ne perputhje me ligjin.

**§ 5**  
**Marreshja per Nivelin e Sherbimit**

(1) Marreshja per Nivelin e Sherbimit duhet te perfshije kushtet, detyrimet dhe masat te cilat ne veqanti i sherbejne arritjes se qelimeve te percaktuara ne ligjin "Per Autoritetin Rrugor Shqiptar" dhe te percaktoje:

1. perdorimin e fondeve ne perputhje me parimet me ekonomike, efektive dhe sipas praktikave me te mira te biznesit;
2. mbajtjen e te gjitha te dhenave financiare dhe faturave me qellim qe te pasqyrohet perdorimi i fondeve sipas marreshjes nepermjet auditimit;
3. kryerjen e raportimeve te menjehershme per cdo suate e cila do te vononte ose do te bente te pamundur realizimin e projekteve per te cilat jane vene ne dispozicion fondet;
4. hartimin e planeve te punes per zbatimin e cdo projekti;
6. dorezimin e raporteve menjehere pas realizimit te cdo projekti, perfshire masat e marra dhe rezultatet e arritura si dhe te dhenat financiare per perdorimin e fondeve dhe perfitimet dhe shpenzimet ne lidhje me projektin;
7. lejimin e kontrollit nga Ministria pergjegjese per Punet Publike ne dosjet, faturat si dhe 9do dokumenti tjeter qe sherben per vleresimin e realizimit te projektit, lejimin e kontrollit ne vend dhe sigurimin e cdo informacioni ne lidhje me projektin.

**§ 6**  
**Funksionet e ARSH**

(1) Funksioni i ARSH eshte te pergatise dhe zbatoje masa te administrimit te rrjetit rrugor shteteror, me theks te vecante mbi interesin publik ne perputhje me Kodin Rrugor dhe ligjin "Per Autoritetin Rrugor Shqiptar". Autoriteti, nese do te konsiderohet e domosdoshme, mund te permbushe funksionet e tij ne bashkepunim me institucionet e tjera pjesemarrrese ne sektorin e transportit publik rrugor. Ne kete kuptim, Autoriteti duhet te ushtroje funksionet e meposhtme:

1. Pergatitja e programeve dhe projekteve dhe lidhja e marreshjeve mbi masat e administrimit te rrjetit rrugor shteteror ne kuptim te programeve \_\_\_\_\_ vjecare per ndertimin, rindertimin, mirembajtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e rrugeve shteterore ne perputhje me dokumentet strategjike si dhe realizimin e programeve ne fjale, projekteve dhe masave;

**Asistenca Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve te ristrukturuar (DPRr) -  
Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

2. Mbeshtetje te qendrueshme zhvillimit ekonomik, social dhe ekologjik ne rrjetin rrugor shteteror duke perdorur fonde publike ne perputhje me nenin 4; krijimi i qendrave te menaxhimit elektronik te trafikut dhe miratimi i statutit te tyre;
  3. Zhvillimi dhe mirembajtja e sistemeve te administrimit te rrugeve shteteror dhe urave; garantimi i sigurise rrugore per perdoruesit e saj ne te gjitha veprimtarit e tyre; mirembjtja dhe zbatimi i Manualit Shqiptar te Projektimit dhe Ndertimit te Rrugeve si dhe Specifikimet Teknike;
  4. Dhenia e asistences ne perditesimet periodike te Planit Kombetar te Trasnportit per sektorin e transportit rrugor, ne bashkepunim me Institutin e Transportit;
  5. Mbeshtet studime, kerkime shkencore dhe eksperimente per efi9encen e trafikut, qarkullimit dhe sigurise rrugore;
- (2) Autoriteti duhet te hartoje nje program pune vjetor, perfshire ketu buxhetin vjetor dhe parashikimin per buxhetin e vitit pasardhes, i cili duhet te miratohet nga Bordi i Menaxhimit. Programi vjetor i punes duhet te vere ne zbatim programin \_\_\_\_\_ brenda fushes se veprimtarise dhe funksioneve te Autoritetit dhe ne vecanti duhet te perfshije informacion per burimet e nevojshme administrative dhe operationale te domosdoshme per keto qellime. Autoriteti duhet te vere ne zbatim programin vjetor te punes ne perputhje me fondet e percaktuara ne ligjin "Per Buxhetin e Shtetit" te vena ne dispozicion per keto qellime te perfshira ne programin ne fjale. £do ndryshim nga programi i punes gjate ushtrimit te veprimtarise se Autoritetit, kerkojne domosdoshmerisht miratim e Bordit i Manaxhimit, i cili duhet te njihet me keto ndryshime perpara miratimit te tyre.

**§ 7  
Bordi i Menaxhimit**

Anetaret e Bordit te Menaxhimit zgjidhen me vendim te Keshillit te Ministrave ne perputhje me nenin 8 paragrafi 2 i ligjit "Per Autoriteti Rrugor Shqiptar".

Bordi i Menaxhimit eshte pergjegjes per:

1. Miratimin e programeve dhe projekteve te Autoritetit;
2. Miratimin dhe auditimin e programeve vjetore te punes, perfshire buxhetin vjetor dhe buxhetin e vitit pasardhes si dhe 9do ndryshim thelbesor te programit vjetor te punes perpara miratimit perfundimtar te tyre sipas \_\_\_\_\_ ;
3. Miratimin e rregullores se brendshme te Autoritetit;
4. Miratimin e te gjitha vendimeve strategjike ne lidhje me fushen e veprimit te Autoritetit;
5. Miratimin e planit te biznesit sipas \_\_\_\_\_ .
6. Emerimin e eksperteve kontabel per te audituar llogarite dhe te dhenat financiare ne lidhje me operationet dhe transaksionet e Autoritetit.

Ne permbushje te pergjegjesive te tij sipas ligjit "Per Autoritetin Rrugor Shqiptar" ose ketij Statuti, Bordi i Menaxhimit mund ti caktojte Drejtorit te Pergjithshem detyra te tjera specifike, per tu kryer nga ky i fundit.

Bordi i Menaxhimit mund te vendos te kryejne inspektime ne lidhje me permbushjen e detyrave te Drejtorit te Pergjithshem.

## § 8

### Procesi i Vendimmarrjes ne Bord

- (1) Bordi duhet te organizoje mbledhjet e tij ne vendin dhe kohen e percaktuar sipas ketij neni.
- (2) Bordi duhet te mblidhet te pakten nje here ne muaj. £do mbledhje tjeter do te caktohet sipas gjykimit te vete Bordit sipas procedures se meposhtme.
- (3) Kryetari i Bordit, vete, ose me kerkese te nje prej anetareve te Bordit, mund te therrase mbledhjen e Bordit te Menaxhimit duke njoftuar antaret e tjere per mbledhjen ose duke autorizuar Drejtorin e Pergjithshem te kryeje nje njoftim te tille.
- (4) Njoftimi per mbledhjen e Bordit te Menaxhimit duhet te permbaje:
  - (a) daten dhe oren e propozuar; dhe
  - (b) axhenden e propozuar per diskutim.
  - (c) Te gjitha mbledhjet e Bordit duhet te mbahen ne \_\_\_\_\_ .
- (5) Njoftimi per mbledhjet e Bordit te Menaxhimit duhet ti behen te ditur me shkrim anetareve te tij, \_\_\_\_\_ dite perpara mbajtjes se tij. Drejtori i Pergjithshem duhet te marre pjese ne 9do mbledhje te Bordit sa here qe kerkohet nga Kryetari.
- (6) Ne mbledhjet e bordit nuk mund te votohet asnje propozim tjeter ne rast se shumica e antareve te tij nuk eshte pjesemarrrese, me perjashtim te propozimit per caktimin e nje mbledhjeje tjeter.
- (7) Mbledhet e Bordit te Menaxhimit kryesohen nga Kryetari i cili eshte pergjegjes per mbajtjen e process-verbalit te mbledhjes se Bordit.
- (8) Bordi i Menaxhimit merr vendimet me shumice te thjeshte. Ne rast barazie ne votim, shumicen e percakton vota e Kryetarit. Drejtori i Pergjithshem nuk ka te drejte vote. £do vendim i marre ne mbledhjen e Bordit te Menaxhimit eshte i vlefshem kur firmoset nga shumica e anetareve te tij pjesemarrres ne mbledhje.
- (9) Gjate procesit te vendimmarrjes anetaret e Bordit te Menaxhimit duhet te deklarojne dhe parandalojne cdo konflikt interesi sipas legjislacionit ne fuqi. Ne rastin e konfliktit te interesit, anetaret nuk lejohen te ushtrojne voten e tyre.

## § 9

### Drejtori i Pergjithshem

Autoriteti ka nje Drejtor te Pergjithshem te emeruar ne perputhje me nenin 12 paragrafi 2 i ligjit "Per Autoritetin Rrugor Shqiptar"

Drejtori i Pergjithshem duhet te perbushe detyrimet e tij te percaktuara ne ligjin "Per Autoritetin Rrugor Shqiptar", kete statut dhe vendimee e Bordit te Menaxhimit me besnikeri ne sherbim te interesave te Autoritetit ne pergjithesi, duke siguruar qendrueshmeri ne veprimet e tij.

**Asistenca Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve te ristrukturuar (DPRr) -  
Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

Drejtori i Pergjithshem perfaqeson Autoritetin ne marredheniet me te trete dhe drejton administrimin e zakonshem si dhe merr vendime per 9eshtje ne lidhje me administrimin, me perjashtim te atyre 9eshtjeve, qe sipas ligjit, ose ketij Statuti jane kompetence e Bordit te Menaxhimit ose Ministrise pergjegjese per transportin rrugor. 9eshtje te nje natyre te jashtezakonshme duhet ti paraqitet gjithmone Bordit te Menaxhimit.

Ne vijim te administrimit te zakonshem te Autoritetit, Drejtori i Pergjithshem eshte pergjegjes per te monitoruar zhvillimet ne perdorimin e transportit rrugor me qellim paraqitjen e strategjive te reja ose ndryshimin e atyre ekzistuese (sipas rastit) perpara Bordit te Menaxhimit.

Drejtori i Pergjithshem ushtron kompetencat e tij ne baze te ligjit Per Autoritetin Rrugor Shqiptar", Statutit dhe Vendimeve te Bordit te Menaxhimit per qellimet e percaktuara ne keto akte duke i dhene rendesine e duhur 9eshtjeve te ndryshme qe kerkojne vendimmarrje.

Drejtori i Pergjithshem duhet te deklaroje ne Bord me shkrim dhe parandaloje 9do konflikt interesi midis personit te tij dhe Autoritetit.

Drejtori i Pergjithshem eshte i detyruar ti raportoje Bordit te Menaxhimit dhe Ministrin pergjegjes per 9eshtjet e puneve publike mbi cdo ngjarje te rendesishme ose ndryshimeve thelbeshore te situatave te ndryshme. Drejtori i Pergjithshem i pergjigjet te gjitha pyetjeve te Bordit te Menaxhimit ne mbledhjen e tij, sa here qe i kerkohet.

Drejtori i Pergjithshem merr vendime ne ushrimin e kompetencave te tij dhe krijon nje sistem te brendshem administrimi me pergjegjesi te ndara ne raportim si dhe objektiva arritjeje per cdo sektor nen mbikqyrjen e tij.

**§ 10  
Udhezime mbi Administrimi**

(1) Autoriteti eshte nje person juridik publik dhe administrohet ne baze te parimeve te ekonomise, efienes dhe efektivitetit.

(2) Autoriteti ka te drejte te ndermarri cdo veprim ose mase qe do te ta konsideroje te domosdoshme per permbushjen e funksioneve te tij. Kjo vlen edhe per krijimin e degeve dhe perfitimin e interesave te ndryshme.

(3) Autoriteti duhet te siguroje sherbimet nen kushtet e konkurrences sipas ligjit "Per Prokurimin Publik" ne permbushje te funksioneve te percaktuara ne ligjin "Per Autoritetin Rrugor Shteteror". Ne sistemin fiskal te Autoritetit, sherbimet e kryera nen kushtet e konkurrences si dhe sherbimet e tjera duhet te mbahen/shenohen ne pasqyra te ve9anta financiare.

(4) Drejtori i Pergjithshem duhet te hartoje nje plan biznesi per 9do vit financiar dhe ta paraqese ate perpara Bordit te Menaxhimit per miratim. Plani i biznesit duhet te permbaje ne ve9anti rezultatet qe kerkohen te arrihen nga Autoriteti, strategjite si dhe planet per punesimin e stafit dhe perdorimin e burimeve fizike, investimet dhe financimin duke marre ne konsiderate funksionet e parashikuara ne nenin 5 te ligjit "Per autoritetin Rrugor Shqiptar". (Plani i biznesit do te pergatitet dhe miratohet cdo vit sipas menyres se percaktuar ne kete statut brenda te njejtës date te miratimit te tij te pare gjate vitit pasardhes).

**Asistenca Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve te ristruktuar (DPRr) -  
Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

(5) Drejtori i Pergjithshem duhet te siguroje ngritjen e nje sistemi planifikimi dhe raportimi, i cili do te siguroje permbushjen e detyrimeve te Autoritetit per informacion dhe qe do te mundesoje vleresimin e masave te marra nga Autoriteti ne ushtrim te veprimtarise dhe permbushje te funksioneve te tij me eficience.

(6) Autoriteti mund te perdore sherbimet e perfaqesimit te Avokatures se Pergjithshme te Shtetit kundrejte shperblimit.

**§ 11**

**Detyrat Specifike per Drejtorin e Pergjithshem**

1. Ne administrimin e zakonshem te Autoritetit, Drejtori i Pergjithshem duhet:

- Te negocioje dhe firmose Marreveshjen vjetore per Nivelin e Sherbimit me Ministrine pergjegjese per 9eshtjet e puneve publike ose marreveshje te tjera financimi me pale te treta;
- Te mbikqyre te gjitha funksionet financiare, perfshire hartimin dhe perdorimin e buxhetit, analizat financiare, raportimet ne lidhje me tatimet dhe administrimin e perfitimeve dhe fondeve;
- Te lidhe dhe menaxhoje kontrata, plane sherbimi dhe mirembajtjeje dhe te ndermarre operacione mbikqyrjeje ne perputhje me funksionet e Autoritetit;
- Te asistoj ne planifikimin dhe zbatimin e infrastruktures se Teknologjise se Informacionit per Autoritetin;
- Te percaktoje marredheniet midis punes se kryer nga punemarresit dhe qellimit te realizimit te objektivave nga ana e Autoritetit;
- Te mase performancen e punes se te gjitha te punesuarve ne baze te rezultatit te pritur;
- Te permiresoje komunikimin midis punemarresve dhe stafit te menaxhimit dhe;
- Te monitoroje progresin dhe te organizoje takime me sektoret nen mbikqyrje;
- Te krahasoje performancen e punemarresve ne kryerjen e detyrave dhe
  - te shperbleje punonjesit qe kane tejkualuar rezultattet e pritura,
  - te motivoje punonjesit qe kane arritur rezultate te larta,
  - te marre vendime te drejta ne lidhje me menaxhimin e personelit, duke marre me pare miratimin e Bordit.
- Te dokumentoje cdo zhvillim te Autoritetit nga vleresimi i tij i fundit;
- Te pergatise dhe paraqese raporte dhe vendime perpara Bordit te Menaxhimit te Autoritetit;
- Te pergatise raportet te cilat Autoriteti duhet ti dorezoje ne Ministrine pergjegjese per punet publike ne lidhje me 9eshtjet e administrimit te Autoritetit;

**Asistenca Teknike per Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve te ristrukturuar (DPRr) -  
Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSh)**

- Te kujdeset per kontaktet me institucione investimi shqiptare dhe te huaja.  
**(Shenim:** *Ne baze te nenit 3 te ligjit "Per Autoritetin Rrugor Shqiptar", statuti i Autoritetit do te miratohet me vendim te Keshillit te Ministrave)*